



Republika e Kosovës
Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Dragashit / Opština Dragaš / Dragas Municipality



KUVENDI I KOMUNËS NË DRAGASH

Ne baze të nenit 12, paragrafi 1, 2 pika d) neni 40 të Ligjit Nr-03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008", neni 56 të Statutit të Komunës së Dragashit - 01 Nr.06-103/1 të datës 11.09.2008, Kërkesës së Organizatës së Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës – Sharr, pas propozimit të Kryetarit të Komunës së Dragashit në mbledhjen e mbajtur më 29.04.2025, pash shqyrtimit dhe votimit paraparak miraton këtë:

VENDIM
PËR NDRYSHIMIN E DATËS SË ÇLIRIMIT TË KOMUNËS SË DRAGASHIT NGA 15
QERSHOR NË 12 QERSHOR

Neni 1

APROVOHET kërkesa e Organizatës së Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dega në Dragash – Sharr (me nr. të protokollit 01Nr.130/01-6874/25 dt. 15.04.2025), që data zyrtare e Çlirimit të Komunës së Dragashit caktohet të jetë **12 Qershor 1999**, duke zëvendësuar datën e mëparshme 15 Qershor.

Neni 2

- Ky ndryshim bëhet mbi bazën e fakteve historike të dokumentuara, ku më datë 12 Qershor 1999:
- Njësi i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) është vendosur në objektin e stacionit policor në Dragash;
 - Njësitet e UÇK-së janë vendosur gjithashtu në qytetin e Prizrenit dhe Dragashit në të njëjtën datë;
 - Në Dragash është pozicionuar kontingjenti gjerman i forcave paqeruajtëse të KFOR-it;
 - Më 13 Qershor 1999, forcave të KFOR-it gjerman iu është bashkuar edhe kontingjenti turk

Neni 3

Me këtë vendim, institucionet komunale **OBLIGOHEN** që në dokumentet zyrtare, materialet përkujtimore dhe veprimtaritë publike të përcaktojnë 12 Qershorin si datën përkujtimore të Çlirimit të Komunës së Dragashit.



Neni 4

Për zbatimin e këtij Vendimi do të përkujdeset Kryetari i Komunës në bashkëpunim Drejtoritë e Komunës së Dragashit dhe OVL UÇK dega në Dragash.

Neni 5

Vendimi, hyn në fuqi 30 ditë pas dërgimit në organin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 8 dhe nenit 9 të Ligjit Nr.08/L-284, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 24/2024'' dhe pas publikimit në tabelën e shpalljeve dhe faqen zyrtare të Komunës.

Arsyetim

Bazuar në dokumente dhe dëshmi historike të mbledhura nga periudha pas përfundimit të luftës së fundit në Kosovë, rezulton se data e saktë e çlirimit të Komunës së Dragashit është 12 Qershor 1999, dhe jo 15 Qershori siç është shënuar deri më tani në dokumentet zyrtare.

Në këtë datë, njësi i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) është vendosur në objektin e stacionit policor të Dragashit, duke shënuar kështu çlirimin efektiv të territorit të komunës. E njëjta datë është zyrtarisht e njohur edhe si dita e Çlirimit të Prizrenit, gjë që dëshmon për një veprim të koordinuar të forcave të UÇK-së në këtë rajon.

Po ashtu, më datë 12 Qershor 1999, në Dragash është pozicionuar kontingjenti gjerman i forcave të KFOR-it, ndërsa më 13 Qershor 1999, atyre u është bashkuar edhe kontingjenti turk. Kjo dëshmon për kalimin e kontrollit dhe fillimin e epokës së pasluftës në komunë.

Ndryshimi i datës nga 15 Qershor në 12 Qershor përfaqëson një korrigjim të domosdoshëm historik dhe institucional, për të përkujtuar me saktësi kontributin për liri dhe çlirim në këtë komunë.

KUVENDI I KOMUNËS - DRAGASH

01 Nr. 069/01-7359-3/25

Dt. 29.04.2025

Kryesuesja e Kuvendit
Arijeta Skeraj



A. Skeraj





**ORGANIZATA E VETERANËVE TE LUFTËS SË USHTRISË
ÇLIRIMTARE TË KOSOVËS
SHARR**

Nr:010/25

Datë:15.04.2025

Sharr

PËR: Kryetarin e Komunës,
zt.Bexhet Xheladini

PËR:Kryesuesen e Kuvendit te Komunës
znj.Arjeta Skeraj

NGA: OVL-UÇK dega në Sharr

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
Komuna e Dragashit - Opština Dragash

Marrë në dorëzim Primiçeno 15.04.2025				
Njësta org. Org.Jedlin	Numri Graj	Më Dl.	Shtetja Prilog	Vlera Vrednosit
	01	130/01-6374		-

LËNDA: Kërkesë për ndryshimin e datës zyrtare të çlirimit të Komunës së Dragashit nga data 15 Qershor në 12 Qershor

Të nderuar!

Data 12 Qershor është data kur njësitë e UÇK-se është pozicionuar në stacionin policor të komunës së Dragashit .

Gjithashtu data 12 Qershor është data e Çlirimit të Prizrenit ku njësitet e UÇK-së janë vendosur ne këto dy komuna në te njëjtën datë.

Lidhet fakti se edhe KFOR-i Gjerman është pozicionuar me datë 12 Qershor në Komunën e Dragashit dhe pas një dite, me datë 13.06.1999 i është bashkangjitur edhe KFOR-i Turk.

Ne kërkojmë qe data e Çlirimit te Komunës e Dragashit te përputhet 100 % me kohën kur ka ndodhur kjo ngjarje historike dhe e shënuar në Komunën e Dragashit.

Kryetari i OVL-UÇK


Emri Neshati
